



Pranimar / Dorezuar Punimena/Prodato Received/Delivered	27.11.2023	3	vin godit Year
Organ /Jedinesia Organ /Unit	Nr Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kohësina Quantity
SKMMSHOK	7124	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1282/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës më numër A.nr.1282/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1282/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesja
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 13.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është e regjistruar nën shenjen A.nr.1282/2023 dhe me numër të protokollit: 6532/2023, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*tani e tutje KQZ*), me pretendim ankimor se të njëjtës gjatë periudhës kohore nga data 30.09.2009 deri me datë 30.08.2011 sa ka qenë e angazhuar në KQZ nuk i janë paguar kontributet pensionale.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja sipas vërtetimit të datës 08.06.2021 të lëshuar nga Drejtoresha e Departamentit të Administratës dhe Përkrahjes në SKQZ konfirmohet fakti se e njëjta për periudhën nga 30.08.2009-30.08.2011 ka qenë e angazhuar në kuadër të KQZ-së në cilësi të "Koordinatorë e Terrenit në SKQZ" mirëpo përveç vërtetimit nuk ka afuar dëshmi tjetër përmes së cilës konfirmohet statusi i saj i nëpunësit civil, ndërsa nga përgjigja

në ankesë e datës 26.10.2023 të Udhëheqëses së Divizionit të Personelit në Sekretariatit të KQZ-së, konfirmohet fakti se e ankuesja gjatë kohës kontestuese nuk e ka pasur statusin e nëpunëses civile madje këtë status nuk e ka as në momentin e parashtrimit të kësaj ankese, ndërsa në bazë të korrespondencës përmes e-mailit të datës 02.10.2023 ndërmjet Udhëheqëses së Divizionit të Personelit të Sekretariatit të KQZ-së dhe ankueses arrihet në përfundimin se për periudhën e njëjtë kohore nga data 30.08.2009 deri më 30.08.2011 ankuesja ka qenë e angazhuar përmes marrëveshjes për shërbime të veçanta sikurse përcaktohej asaj kohe me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 12 paragrafi 4: *“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”.*

Kolegji i Këshillit lidhur me kompetencën e shqyrtimit të ankesës së ankueses iu referuar nenit 2 paragrafit 3 të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”*, ndërlidhur me nenin 5 paragrafi 2 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: *“Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë”*, si dhe përgjigjes të datës 26.10.2023 së Udhëheqëses së Divizionit të Personelit të Sekretariatit të KQZ-së dhe erdhi në përfundimin se ankuesja për periudhën kontestuese nga data 30.09.2009 deri me datë 30.08.2011, madje as tani nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Tutje, Kolegji i Këshillit iu referua edhe dispozitave të ligjit i cili ka qenë në fuqi gjatë njëres pjesë të afatit kohore të periudhës kontestuese, si dhe nenit 1 të Ligjit Nr. 03/L-161 Ligji Për Tatimin Në Të Ardhurat Personale ku përcaktohej se: *“Ky ligj vendos sistemin e Tatimit në të Ardhurat Personale në territorin e Republikës së Kosovës.”* dhe nenit 1 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili përcakton se: *“Ky ligj vendos sistemin e Tatimit në të Ardhurat Personale në territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa përjashtimi nga të ardhurat personale është paraparë me nenin 8 të këtij ligji, kurse lidhur me zbatimin e këtij ligji është nxjerr Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili me nenin 11 ka përcaktuar të ardhurat e përjashtuara nga të ardhurat personale dhe duke marr për bazë që dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat që janë në fushëveprimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale siç parashihet me nenin 2 të këtij udhëzimi, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat është përcaktuar mënyra e nxjerrjes së vendimeve shpjeguese individuale, si rrjedhojë bazuar në dispozitat e cekura më lartë përcaktohet se Administrata Tatimore e Kosovës është organi përgjegjës dhe mbikëqyrës lidhur zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me tatimet duke përfshirë edhe tatimin në burim apo të ardhurat personale.



Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit ndërlidhur me pretendimet e tij, në mbështetje të nenit 21 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj. 2. Nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi publik i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencën lëndore mbi atë çështje", si dhe duke marr për bazë nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas të cilit nen përcaktohet se Këshilli ka kompetencë të shqyrtoj dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, andaj duke u mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore të trajtoj ankesën e ankuesit lidhur me këtë pretendim për mos pagim të kontributeve pensionale sikurse nuk ka kompetencë ta trajtojë këtë lëndë as për shkakun se ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e parashtuara nga ankuesi lidhur me pretendimet e tij, rrjedhimisht Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lenda t'i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Administratës Tatimore të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1282/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;